



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 51

Tiranë – E hënë, 9 mars 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 5, datë 3.3.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” 3763
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 6, datë 3.3.2026	Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 9, datë 3.5.2024, “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” 3763
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 116, datë 27.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 167, datë 27.4.2022, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, të ndryshuar..... 3764
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 117, datë 27.2.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 192, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimit të provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve” 3766
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3864, datë 4.3.2026	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare..... 3769
	Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 160, datë 17.10.2014..... 3769



UDHËZIM
Nr. 5, datë 3.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.7.2023,
“PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR
KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE
TË PUNONJËSVE ARSIMORË NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi “Ministria e Arsimit dhe Sportit” zëvendësohet me “Ministria e Arsimit” dhe akronimi “MAS” zëvendësohet me “MA”.

b) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “Arti skenik” zëvendësohet me togfjalëshin “Arte skenike”.

c) Në pikën 3, të shtojcës 1, për lëndët “Art pamor”, “Muzykë” dhe “Kërcim”, te profili i përfaqësuar të shtohet “Arte skenike”.

d) Në shkronjën “a” të pikës 4, të shtojcës 1, për lëndën “Ekonomi”, profili i kërkuar të bëhet “Ekonomi” dhe profili i përfaqësuar të bëhet “Shkenca sociale”.

e) Në shkronjën “b”, të pikës 4, të shtojcës 1, për lëndën “Arte”, te profili i kërkuar të shtohet “Koreografi”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani

UDHËZIM
Nr. 6, datë 3.3.2026

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË
SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 9,
DATË 3.5.2024, “PËR ORGANIZIMIN
E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË
KANDIDATËVE PËR T’U PUNËSUAR
NË INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 9, datë 3.5.2024, “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, bëhet shtesa dhe ndryshimi, si poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, emërtimi “Ministria e Arsimit dhe Sportit” zëvendësohet me “Ministria e Arsimit” dhe akronimi “MAS” zëvendësohet me “MA”.

b) Në nenin 12, pas fjalës “balet”, shtohet togfjalëshi “arte skenike”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani



URDHËR

Nr. 116, datë 27.2.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHËRIN E MINISTRIT TË
DREJTËSISË NR. 167, DATË 27.4.2022,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË HOLLËSISHME PËR
PARAQITJEN DHE TRAJTIMIN E
SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË
KRITEREVE LIGJORE PËR
PËRKTHYES ZYRTAR DHE PËR
INTERPRET TË GJUHËS SË
SHENJAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 14, pika 6, dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 167, datë 27.4.2022, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

1. Në nenin 3, bëhen shtesat si më poshtë:

a) në pikën 3, bëhen shtesat si më poshtë:

i. në shkronjën “e”, pas togfjalëshit “të nënshkruar” shtohet togfjalëshi “dhe/ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore”;

ii. pas shkronjës “e”, shtohen shkronjat “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“ë) formularin e vetëdeklarimit mbi zotërimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetim nga gjykata për zotërimin e zotësisë për të vepruar;

f) në rast se përzgjedh kryerjen e njoftimeve të përcaktuara në këtë urdhër me mjete të komunikimit elektronik, deklarimin mbi dhënien e pëlqimit mbi kryerjen e njoftimeve me mjete të komunikimit elektronik, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij

urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar.”;

b) në pikën 5, bëhen shtesat si më poshtë:

i. në shkronjën “c”, pas togfjalëshit “të nënshkruar” shtohet togfjalëshi “dhe/ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore”;

ii. pas shkronjës “c”, shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“ç) formularin e vetëdeklarimit mbi zotërimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar dhe/ose vërtetim nga gjykata për zotërimin e zotësisë për të vepruar;

d) në rast se përzgjedh kryerjen e njoftimeve të përcaktuara në këtë urdhër me mjete të komunikimit elektronik, deklarimin mbi dhënien e pëlqimit mbi kryerjen e njoftimeve me mjete të komunikimit elektronik, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar.”.

2. Neni 5 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë vlerëson shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit për përkthyes zyrtar ose për interpret të gjuhës së shenjave, brenda 20 (njëzetë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre.

2. Kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë njofton kandidatin për plotësimin e të metave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Në çdo rast, struktura përgjegjëse i njofton kandidatit numrin unik të identifikimit që do të përdoret për qëllime të publikimit të listave të kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.”.

3. Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, struktura përgjegjëse verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj dhe në këtë urdhër, në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.”;

b) pika 2, shfuqizohet;

c) pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Në përfundim të verifikimit mbi plotësimin kriterëve ligjore, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton një relacion



shpjegues për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm. Në relacion pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e shprehjes së interesit, për secilin kandidat.”.

4. Në nenin 8, pika 2, togfjalëshi “5 (pesë)” zëvendësohet me togfjalëshin “10 (dhjetë)”.

II. Ngarkohet struktura përgjegjëse për përkthimin zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë dhe komisionet e posaçme përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

III. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari

Shtojca nr. 1

VETËDEKLARIM MBI ZOTËRIMIN E ZOTËSISË SË PLOTË PËR TË VEPRUAR

Unë, i nënshkruari/a

Emri: _____

Atësia: _____

Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Numri personal (NID): _____

Vendbanimi: _____

në cilësinë e kandidati/es për përkthyes/e zyrtar/e/interpret/e i/e gjuhës së shenjave, në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar dhe të urdhrit nr. 167, datë 27.4.2022 të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, i ndryshuar,

VETËDEKLAROJ, me përgjegjësi të plotë ligjore, se:

1. Zotëroj zotësinë e plotë për të vepruar, në kuptim të legjislacionit civil në fuqi;

2. Jam plotësisht i/e vetëdijshëm/e se ky vetëdeklarim paraqitet si dokumentacion për qëllime zyrtare dhe shërben si kusht për verifikimin e

përbushjes së kriterit të zotërimit të zotësisë së plotë për të vepruar sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar;

Me këtë vetëdeklarim, jap edhe pëlqimin tim të shprehur, të lirë dhe të informuar që Ministria e Drejtësisë të përpunojë të dhënat e mia personale dhe të kryjë verifikimet e nevojshme pranë institucioneve publike kompetente, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së këtij vetëdeklarimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Ky vetëdeklarim është hartuar me vullnet të lirë, pa asnjë imponim, dhe nënshkruhet prej meje për t’u përdorur në kuadër të trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Shtojca nr. 2

VETËDEKLARIM MBI MARRJEN E NJOFTIMEVE ME MJETE ELEKTRONIKE

Unë, i nënshkruari/a:

Emri: _____

Mbiemri: _____

Numri personal (NID): _____

në cilësinë e kandidati/es për përkthyes/e zyrtar/e/interpret/e i/e gjuhës së shenjave, në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar dhe të urdhrit nr. 167, datë 27.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave”, i ndryshuar,

VETËDEKLAROJ, me përgjegjësi të plotë ligjore, se:



1. Jap pëlqimin tim të shprehur, të lirë dhe të informuar që njoftimet, komunikimet dhe çdo komunikim që lidhet me procedurën e trajtimit të shprehjes së interesit, verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave, si dhe çdo procedurë tjetër të parashikuar nga urdhri i sipërcituar, si dhe urdhri me nr. 192, datë 4.5.2022, i ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimin e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve”, i ndryshuar, të kryhen nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik;

2. Për qëllimet e mësipërme, deklaroj se adresa ime elektronike e kontaktit është _____;

3. Jam i/e vetëdijshëm/e dhe pranoj se njoftimet e kryera nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në të dhënat e kontaktit të deklaruara më sipër konsiderohen të vlefshme dhe të rregullta, në kuptim të legjislacionit në fuqi;

4. Marr përsipër përgjegjësinë për saktësinë, përditësimin dhe funksionalitetin e adresës elektronike të dekluarar, si dhe për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjoftimi në kohë i strukturës përgjegjëse për çdo ndryshim të tyre;

Ky vetëdeklarim është hartuar me vullnet të lirë, pa asnjë imponim, dhe nënshkruhet prej meje për t’u përdorur në kuadër të trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

URDHËR

Nr. 117, datë 27.2.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN E MINISTRIT TË
DREJTËSISË NR. 192, DATË 4.5.2022,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
MË TË HOLLËSISHME PËR KRITERET,
PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E
PËRFAQËSUESVE DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË
POSAÇME, TARIFAT PËR
PJESËMARRJE, ORGANIZIMIN E
ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË
KUALIFIKIMIT PËR PËRKTHYES
ZYRTAR DHE PËR INTERPRET TË
GJUHËS SË SHENJAVE, SI DHE PËR
PROCEDURËN E MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË PROVIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 16, pika 8, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 192, datë 4.5.2022, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimin e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve”, ndryshohet si më poshtë:

1. Në nenin 5, pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Përfaqësuesi në komisionet e posaçëm për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar për gjuhët për të cilat institucionet e arsimit të lartë nuk ofrojnë programe studimi, duhet të plotësojë kriteret e veçanta të mëposhtme:

i. përfaqësuesi nga misionet diplomatike ose postet konsullore duhet të jetë i punësuar pranë misionit diplomatik ose postit konsullor për një periudhë prej jo më pak se 3 vitesh dhe të jetë njohës i gjuhës përkatëse;



ii. përfaqësuesi nga organizatat ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë i punësuar pranë organizatës ndërkombëtare, që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, për një periudhë prej jo më pak se 3 vitesh dhe të jetë njohës i gjuhës përkatëse;

iii. përfaqësuesi nga autoritetet e tjera të huaja, duhet të jetë i punësuar pranë autoritetit të huaj, duhet të jetë i punësuar për një periudhë prej jo më pak se 3 vitesh dhe të jetë njohës i gjuhës përkatëse;

iv. përfaqësuesi nga përkthyesit zyrtarë të certifikuar duhet të jetë i certifikuar për gjuhën përkatëse.”

2. Neni 8, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kandidati për anëtar i komisionit të posaçëm, për të provuar përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) kopje të mjetit të identifikimit;

b) jetëshkrimin;

c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njehsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

ç) vërtetim nga institucionet dhe personat juridikë privatë ku ka ushtruar detyrën ose funksionin publik apo me të cilat ka lidhur marrëdhënien e punës se ndaj tij nuk është dhënë masa disiplinore e shkarkimit për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, ose nëse është dhënë kjo masë, vërtetim që kjo masë disiplinore është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) kopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës, nëse ka të tillë;

dh) vërtetim nga institucioni ku punon kandidati;

e) deklarin mbi dhënien e pëlqimit mbi kryerjen e njoftimeve me mjete të komunikimit elektronik, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse të tij, të plotësuar dhe të nënshkruar, në rast se përzgjedh kryerjen e njoftimeve të përcaktuara në këtë urdhër me mjete të komunikimit elektronik;

ë) formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të plotësuar dhe nënshkruar.

2. Kandidati për anëtar i komisionit të posaçëm për provimin e kualifikimit, për të provuar

përmbushjen e kriterëve të posaçme, paraqet dokumentacionin shoqërues si vijon:

a) përfaqësuesi nga Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale paraqesin vërtetime nga ministria përkatëse mbi zotërimin e statusit të nëpunësit civil;

b) përfaqësuesi nga institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja paraqesin vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë që vërtetojnë se kandidati është pjesë e personelit akademik të tij, i angazhuar me kohë të plotë, i kategorisë lektor ose profesor, me përvojë profesionale në mësimdhënie jo më pak se 5 vjet, në gjuhën përkatëse ose të ngjashme me të, ose që lidhet me fushën e përkthimit;

c) përfaqësuesit nga misionet diplomatike, postet konsullore, organizatat ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë dhe autoriteteve të tjera të huaja, paraqesin vërtetim nga subjekti ku janë punësuar, nëse nuk disponojnë librezën e punës, për vërtetimin e përvojës së punës, si dhe çdo dokument që vërteton njohjen e gjuhës përkatëse;

ç) përfaqësuesit nga radhët e interpretëve paraqesin:

i. vërtetime dhe çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati ka jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë profesionale në interpretimin e gjuhës së shenjave shqipe; ose

ii. vërtetime dhe çdo dokumentacion tjetër që provon se kandidati ka jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë profesionale si trajnues i certifikuar i programit të interpretëve të gjuhës së shenjave shqipe, shoqëruar me dokumentacionin që provon certifikimin e tij.”

3. Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“1. Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë vlerëson shprehjet e interesit dhe dokumentacionin shoqërues të kandidatit për anëtar të komisioneve të posaçme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e tyre.

2. Kur shprehja e interesit dhe dokumentacioni shoqërues nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij urdhri, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë njofton kandidatin për plotësimin e të metave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Në çdo rast struktura përgjegjëse i njofton kandidatit numrin unik të identifikimit, i cili do të



përdoret për qëllime të publikimit të listave të kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.”.

4. Në nenin 10, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit për plotësimin e të metave, struktura përgjegjëse verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë urdhër, në përputhje me parimet dhe rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.”;

b) pika 2, shfuqizohet;

c) pika 4, ndryshohet si më poshtë:

“4. Në përfundim të verifikimit mbi plotësimin kriterëve ligjore, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë harton një relacion shpjegues për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm. Në relacion pasqyrohen të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe arsyet mbi propozimin për pranimin ose refuzimin e shprehjes së interesit, për secilin kandidat.”.

5. Neni 11 shfuqizohet.

6. Në nenin 13, pika 2, togfjalëshi “5 (pesë)” zëvendësohet me togfjalëshin “10 (dhjetë)”.

7. Në nenin 15, pika 1, togfjalëshi “një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë” zëvendësohet me togfjalëshin “përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë”.

8. Në nenin 19, në titull, pas fjalës “gjuhës” shtohet togfjalëshi “së shenjave”.

9. Në nenin 24, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë:

a) në pikën 3, togfjalëshi “si dhe kodin e provimit”, shfuqizohet;

b) pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Një nëpunës i sektorit të Arkiv-Protokollit shënon kodin e provimit përbri emrit të secilit kandidat në listën e hartuar për këtë qëllim, të cilën e mban nën administrim deri në përfundim të sekretimit të të gjithë testeve. Pas shumëfishimit dhe shpërndarjes së testit, nëpunësi i sektorit të Arkiv-Protokollit kalon pranë çdo kandidati dhe shënon në anën e majtë të pjesës së sipërme të testit kodin e secilit kandidat. Më pas mbyll me kapëse pjesën ku është shënuar kodi dhe vulos me vulën e Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë të tillë që vula të vendoset pjesërisht në pjesën e mbyllur dhe pjesërisht në faqen e parë të tezës. I gjithë ky proces kryhet në mënyrë të tillë që asnjë kandidat dhe asnjë anëtar i komisionit të mos marri dijeni për kodin e provimit të kandidatëve.”;

c) pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Pas përfundimit të shënimit të kodeve për të gjithë kandidatët, lista mbyllet në një zarf të veçantë i cili vuloset dhe ruhet në sektorin e Arkiv-Protokollit.”.

10. Në nenin 27, pika 3, fjala “automatik”, shfuqizohet.

Dispozita pas nenit 35, numërohet “Neni 36”.

II. Ngarkohet struktura përgjegjëse për përkthimin zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë dhe komisionet e posaçme përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

III. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari

Shtojca nr. 1

VETËDEKLARIM

MBI MARRJEN E NJOFTIMEVE ME
MJETE ELEKTRONIKE

Unë, i nënshkruari/a

Emri: _____

Mbiemri: _____

Numri personal (NID): _____

në cilësinë e kandidati/es për anëtar komisioni të posaçëm për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave shqipe, në mbështetje të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 192, datë 4.5.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave më të hollësishme për kriteret, procedurat për përzgjedhjen e përfaqësuesve dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, tarifat për pjesëmarrje, organizimin e zhvillimin e provimit të kualifikimit për përkthyes zyrtar dhe për interpret të gjuhës së shenjave, si dhe për procedurën e mënyrën e vlerësimit të provimeve”;

VETËDEKLAROJ, me përgjegjësi të plotë ligjore, se:

1. Jap pëlqimin tim të shprehur, të lirë dhe të informuar që njoftimet dhe çdo komunikim që lidhet me procedurën e trajtimit të shprehjes së interesit, verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore



për përkthyes zyrtar/interpret të gjuhës së shenjave, si dhe çdo procedurë tjetër të parashikuar nga urdhri i sipërcituar, të kryhen nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik;

2. Për qëllimet e mësipërme, deklaroj se adresa ime elektronike e kontaktit është: _____;

3. Jam i/e vetëdijshëm/e dhe pranoj se njoftimet e kryera nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në adresën elektronike të deklaruar më sipër konsiderohen të vlefshme dhe të rregullta, në kuptim të legjislacionit në fuqi;

4. Marr përsipër përgjegjësinë për saktësinë, përditësimin dhe funksionalitetin e adresës elektronike të deklaruar, si dhe për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjoftimi në kohë i strukturës përgjegjëse për çdo ndryshim të tyre;

Ky vetëdeklarim është hartuar me vullnet të lirë, pa asnjë imponim, dhe nënshkruhet prej meje për t'u përdorur në kuadër të trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore për anëtar komisioni të posaçëm për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtar /interpret të gjuhës së shenjave shqipe.

Vendi: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

NJOFTIM

Nr. 3864, datë 4.3.2026

PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. “Protokolli i Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Mbretërisë së Suedisë”, nënshkruar më 5.7.2022, hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë, në datën 7.3.2024.

2. “Protokolli i Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Mbretërisë së Finlandës”, nënshkruar më 5.7.2022, hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë në datën 4.4.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 160, datë 17.10.2014, bëhet korrigjimi i gabimit material, si më poshtë:

Në pikën 1 të nenit 16 të ligjit ndryshohet togfjalëshi “**të nenit 14**” me togfjalëshin “**të nenit 15**”.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

